

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË
VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 06.06.2024

Të dhëna javore

Në periudhën 31.05-06.06.2024 në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 38 raste të reja me pertusis, 26,7% më shumë se javën që shkoi (n=30).

Numri më i madh i tyre (n=26; 68,4%) janë raportuar në Shkup, 4 në Manastir, 3 në Tetovë dhe nga 1 në Probishtip, Prilep, Kumanovë, Gjevgjeli dhe Kavadar. (Tabela 1)

Mosha e të prekurve sillet nga 1 muaj deri në 68 vjet, ndërsa numri më i madh i përkasin grupmoshës 5-9 vjet (n=11; 28,9%).

Nga rastet e reja 6 raste janë hospitalizuar.

Tabela 1. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 31.05-06.06.2024

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	26
Karposh	5
Kisella Voda	4
Aerodrom	3
Gjorçe Petrov	2
Saraj	2
Gazi Baba	2
Çair	2
Shuto Orizare	2
Qendër	1
Butel	1
Petrovec	1
Studenica	1
Manastir	4
Tetovë	3
Tetovë	2
Zhelinë	1
Jegunovc	1
Probishtip	1
Prilep	1
Kumanovë	1
Gjevgjeli	1
Kavadar	1

Të dhëna kumulative

Në vitin 2024, deri me datë 06.06.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 699 raste me pertusis, me një incidencë prej 38,1/100,000 banorë.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 554 (79,3%) në shtatëmbëdhjetë komuna të ndryshme. (Tabela 2).

39 të sëmurë janë regjistruar në Kumanovë, ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 17 qytete të tjera.

Tabela 2. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 2024

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë	Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	554	Manastir	29
Aerodrom	134	Manastir	28
Karposh	94	Mogilla	1
Kisella Voda	66	Prilep	8
Çair	52	Dollnen	5
Qendër	49	Prilep	3
Gjorçe Petrov	33	Gostivar	5
Gazi Baba	29	Gostivar	4
Butel	23	Vrapçisht	1
Studenica	22	Kriva Pallankë	4
Saraj	15	Kratovë	4
Shuto Orizare	13	Strumicë	3
Haraçina	6	Strumicë	2
Petrovec	6	Bosilovë	1
Sopishte	4	Koçan	3
Çuçer Sandevë	3	Kërçovë	3
Ilinden	3	Veles	3
Zelenikovë	2	Probishtip	3
Kumanovë	39	Strugë	2
Kumanovë	34	Dibër	2
Likovë	5	Krushevë	2
Tetovë	29	Kavadar	2
Tetovë	13	Gjevgjeli	2
Zhelinë	6	Demir Hisar	1
Tearc	5		
Brvenicë	3		
Jegunovc	2		
Bogovinjë	1		

Incidencë më e lartë prej 91,3/100.000 është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë e lartë është regjistruar edhe në Kratovë (53,0/100.000), Kumanovë (31,5/100.000), Manastir (31,2/100.000). (Hartogrami)


Hartogrami. Incidenca në 100.000 banorë sipas QSHP/NJR, kolla e keqe në RMV, 2024

Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 78 vjet (mesatarja 11,6 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë deri në 4 vjet (28,3%), 127 ose 18,2% i përkasin grupmoshës nën 1 vjet, 70 (10,1%) janë nga 1 deri në 4 vjet.

Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet ($I=768,1/100.000$). (Grafiku 1).


Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 332 të sëmurë janë meshkuj, ndërsa 367 femra.

Grafiku 1. Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe ($n=597$) sipas moshës, në RMV, 2024



Lakorja epidemike tregon se shfaqja e rasteve të reja të kollës së keqe fillon në javën e parë të vitit 2024. Sipas të dhënave vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të rasteve në bazë javore, deri në javën e 12-të. Nga java e 12-22, me variacione të vogla, numri i rasteve zvogëlohet. Rritje është regjistruar në javën e 10 dhe të 20 të vitit 2024.


Grafiku 2. Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe ($n=699$) sipas javës së raportimit (deri më 06.06.2024), në RMV, 2024



Sa i përket statusit të vaksinimit, 428 (61,2%) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit, ose nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit. (Grafiku 3).

Të vaksinuar me të gjitha dozat në përputhje me moshën janë 271 persona. (Grafiku 3).

Grafiku 3. Statusi i vaksinimit dhe moshja e të sëmurëve (n=699) me kollë të keqe në RMV



Nga të sëmurët në spital janë shtruar 100 persona (14,3%), ndërsa 84 (84,0%) prej tyre janë nën moshën 4 vjet. Numri më i madh i rasteve (69; 69,0%) janë shtruar në KU për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët në Kozle. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të shtruar në spital, 89 janë lëshuar si të shëruar. Të sëmurët kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 9 ditë.

Nga numri i përgjithshëm (n=699) i rasteve të regjistruara me kollë të keqe, 697 janë konfirmuar laboratorikisht, përkatësisht në Avicena (187), Institutin e Shëndetit Publik (175), Biotek (122), Sinlab (56), QSHP Kumanovë (37), SK Sistina (27), QSHP Manastir (22), Laor (19), Instituti i mikrobiologjisë (18), Pllodnost Manastir (12), Klinikën Zhan Mitrev (11), SK Manastir (5), Remedika (4), dhe Ramus (2).

Klasifikimi i rasteve:

Sipas Rregullores për kriteret për definimin e rasteve të sëmundjeve ngjitëse (Gazeta Zyrtare nr. 19/2018), nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara (n=699) të kollës së keqe, 697 janë klasifikuar si raste të konfirmuara (të konfirmuara në laborator) dhe dy si të mundshme (ka një lidhje epidemiologjike me një rast të konfirmuar në laborator). Hetimet epidemiologjike tregojnë një lidhshmëri mes 117 rastesh.

Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit.

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.


Shkup - numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01-06.06.2024

Sipas të dhënave të siguruar nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit nga Gazi Baba dhe Çairi, Karposh, Kisella Voda dhe Qendra, është konstatuar se janë zbuluar 21005 fëmijë që kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar 13696 (65,2%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (6.423; 46,8%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 14.081 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (8.988; 63,8%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01-06.06.2024 është 27.777.

Grafiku 3. Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024





Maqedonia e Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01-06.06.2024

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik, 9.172 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve 6.008 (65,5%) janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (2.816; 46,9%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 19.154 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (10.685; 55,8%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01-06.06.2024 është 25.162.

Grafiku 3. Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024



Përfundime

- Në vitin 2024 janë regjistruar 699 të sëmurë me kollë të keqe.
- Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në territorin e Shkupit (79,3%), ndërsa të sëmurë janë regjistruar në 18 qytete të tjera në RMV.
- Epidemi aktive ka në territorin e Shkupit dhe Kumanovës.
- Numri më i madh i pacientëve i përket grupmoshës 0-4 vjet (28,3%), incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet dhe është 768,1/100.000 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara (699), 428 raste (61,2%) nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk kanë qenë të vaksinuar sipas moshës së tyre ose nuk ka të dhëna për vaksinimin.
- Nga fëmijët që janë vaksinuar plotësisht (n=213), koha mesatare e kaluar nga doza e fundit e vaksinës deri në shfaqjen e sëmundjes është 12.6 vjet.
- Nga 699 rastet e raportuara, në laborator janë konfirmuar 697 raste.

- Nga 18.01-06.06.2024, janë dhënë gjithsej 52.939 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër kollës së keqe.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
ISHPRMV

07.06.2024